VENDIM
Nr. 179, datë 12.3.2012

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, zëri "Shpenzime korente", të bëhet rishpërndarja e fondeve në programet buxhetore, si më poshtë vijon:

a) Në programin "Arsimi profesional", 09240, pakësohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

b) Në programin "Për kërkim fondamental dhe ekselencë", 09770, pakësohet fondi prej 46 700 000 (dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

c) Në programin "Arsimi bazë", 09120, shtohet fondi prej 61 700 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha